



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 644/1 prot.

Tiranë, më 30 . 04 . 2024

V E N D I M

Nr. 124, datë 30 . 04 . 2024

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi² mori në shqyrtim ankesën me nr. 89 Regj., datë 25.04.2024, paraqitur nga shtetasja A. H, kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Çerdheve e Kopshteve, pranë Bashkisë Tiranë, si dhe Kopshtit Nr. 27/K “Harry Potter”, Tiranë, me pretendimin për diskriminim, për shkak të *etnisë*³ dhe *gjendjes shëndetësore*⁴.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues në mes të tjerash informon Komisionerin, se:

“...Problematika ime i ka fillesat që në momentin e parë të regjistrimit të djalit në këtë kopësht. Për shkak të mungesës së vendeve dhe arsytimit që kopshti ngriti, se djali ishte i madh në trup dhe nuk e zinte krevati, e kaluan në grupin e madh të 4 (katër) vjeçarëve. Edhe pse pata diskutime në lidhje me këtë zgjedhje të kopshtit, pasi fëmija do ta kishte të vështirë përshtatjen në grup, për shkak të grupmoshës dhe trajtimit që djali vazhdon të marrë me psikolog dhe terapi përkatëse për vonesat në zhvillim, stafi i kopshtit nuk i mori në konsideratë argumentat e mija.”

¹ Në vijim do t’i referohemi me akronimin LMD.

² Në vijim do t’i referohemi me akronimin KMD ose Komisioneri.

³ Referuar Vërtetimit të lëshuar nga Organizata “Qendra T’REJA”, subjekti ankues i përket pakicës kombëtare egjiptiane në Shqipëri.

⁴ Referuar dokumentit mjekësor me nr. regj. 367, datë 12.04.2024, të Qendrës Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët/QKTRF, rezultoi se fëmija E. T, diagnostikohet me: “Çrregullime të hiperaktivitetit dhe prapambetje mendore të lehtë.”

Njëkohësisht fryma e komunikimit nga stafi i kopshtit ka qenë jo etike dhe është përdorur ndaj nesh gjuhë diskriminuuese. Jemi familje me prejardhje etnike nga minoriteti egjiptian. Në një rast kur kemi shkuar për të marrë fëmijën, na është thënë se djali ka kërcyer tallava gjatë orarit të gjumit. Kjo gjë na ka prekur, pasi e ka vënë në dukje identitetin tonë si minoritet duke na stereotipizuar.

Një ngjarje shqetësuese është kur djali ka pësuar një tik nervor gjatë qëndrimit në kopësht dhe për këtë e kemi shtruar një javë për trajtim në pavionin e neuropediatrisë në SQUNT. Djali edhe pse ka probleme me të kuptuarin dhe vështirësi në të shprehur, për shkak të mangësive logopedike dhe zhvillimit të vonuar, kjo nuk e ka ndaluar të shprehë shqetësimet e tij në lidhje me sjelljen e edukatoreve në kopësht, duke na vënë në dijeni se është gjuajtur me shuplakë gjatë orarit të gjumit nga njëra prej edukatoreve. Kam bërë ankesë tek drejtoresha po na është mohuar totalisht ndonjë veprim dhune ndaj fëmijës tonë dhe për këtë arsye nuk kam vijuar për ta ngritur si çështje në institucionet më të larta.

Në lidhje me trajtim në grupin parashkollor, djali ka ndeshur situata ku një edukatore e ka kapur fort nga dora dhe nga qafa, ndërsa janë përdorur edhe fjalë që kanë cenuar identitetin e tij, sikurse “je i pisët, i zi”, etj, të cilat djali i ka shprehur në ambientet e shtëpisë.

Gjithashtu kam pasur diskutime me drejtoreshën dhe psikologjen e kopshtit, të cilat kanë sugjeruar që të mos i besoj fëmijës, sepse ai është problematik dhe të tregoj besim ndaj stafit. Për të mbështetur fëmijën dhe edukatoren, kam qenë gjithmonë e gatshme për të zbatuar këshillat e psikologes dhe punonjësës sociale, kam shfrytëzuar ndjekjen e terapive të ndryshme, si dhe të siguroj mësues shtesë.

Drejtoresha na është drejtuar me një gjuhë të vrazhdë për sjelljen e djalit në kopësht me argumentin e mungesës së disiplinës nga ana jonë si prindër. Edukatorët kanë hedhur poshtë pretendimet e fëmijës për trajtimin e tij në kopësht dhe na kanë thënë se e trajtojnë në mënyrë të veçantë, duke e mbajtur në tavolinë të ndarë nga grupi dhe në disa raste nuk e përfshijnë në aktivitetet me arsyetimin se e trajtojnë më mirë nga të tjerët. Nuk kemi kërkuar trajtim të diferencuar, pasi kjo mund të kuptohet si një formë ndëshkimi nga fëmija. Drejtoresha ka propozuar një mbledhje bordi për të kërkuar përjashtimin e fëmijës, duke shkelur parimin e trajtimit të barabartë dhe gjithëpërfshirës.”

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të ndërhyjë pranë instancave përkatëse në mënyrë që të merren masa për të shmangur situata të tilla në të ardhmen, si dhe për transferimin e fëmijës në një kopësht tjetër.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen

ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Në nenin 3/1, të LMD parashikohet se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasoje pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.*

Neni 7/1 i LMD-së⁵, parashikon se: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash, përbën diskriminim”.*

Në Kreun IV, të LMD-së parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. LMD në nenin 20/1/a dhe b⁶, ndalon çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi, që i bëhet një personi apo grupi personash në ofrimin e të mirave dhe shërbimeve.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Ligjin 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Në vijim, subjekti ankues, nëpërmjet e-mailit të datës 30.04.2024, të dërguar në adresën e KMD-së, ka kërkuar të tërhiqet nga ankesa, pasi nga ana e subjekteve kundrejt të cilave ka paraqitur ankesën pranë KMD-së, është mundësuar transferimi i djalit në një kopësht tjetër, dhe konsideron që tashmë nuk ka arsye për të vijuar më tej me trajtimin e saj.

Në nenin 32, pika 3, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar përcaktohet: *“3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, Komisioneri zbaton normat e*

⁵ Shkurtesë për Ligjin *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar.

⁶ Neni 20/1/a dhe b, të ligjit nr. 10221/2010: *“Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato: a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi...”*

parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj.

Në nenin 90/3 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikohet se: “Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.

Në nenin 94⁷/1 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikohet se: “Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”.

Procedura administrative konkrete pranë Komisionerit, është iniciuar mbi bazën e ankesës së paraqitur nga subjekti ankues, A. H, e cila, me anë të e-mailit të datës 30.04.2024, është tërhequr nga ankesa e saj pranë KMD-së.

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, si dhe kërkesën për tërheqje nga ankesa të paraqitur nga ankuesja në datën 30.04.2024, Komisioneri vlerëson se, procedura për shqyrtimin e ankesës me nr. 89 regj., datë 25.04.2024, të paraqitur nga ankuesja A. H, nuk mund të vazhdojë, por duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar, për shkak se subjekti ankues është tërhequr nga ankesa dhe nuk identifikohet ndonjë interes publik që do të legjitimonte vazhdimin e procedurës, nga ana e këtij organi publik⁸.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 32, pika 1, shkronja “a” dhe nenin 33, pika 1, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Të deklarohet të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës me nr. 89 Regj., datë 25.04.2024, të znj. A. H, për shkak se subjekti ankues është tërhequr nga ankesa pranë KMD-së.

⁷ “Tërheqja e ankesës”.

⁸ Për analogji citojmë: Vendimin nr. 230, datë 07.11.2023, Vendimin nr. 104, datë 22.04.2024, të KMD-së.

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA